



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1323/ 8 prot.

Datë 12.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 627/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Fastech” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt “Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM” me fond limit 4,080,942.50 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Fastech” SHPK me NIPT J81609010U dhe adresë: *Njesia bashkiake nr 5, rruga Brigada VIII, ndertesa 8, hyrja 6, ap 1, ap 7, Tirane*
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: *Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 09.04.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt “Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM” me fond limit 4,080,942.50 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Pergendruara.

II.2. Në datën 20.04.2026, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 23.04.2026 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Videomobile” SH.P.K 2,775,862.25 lekë skualifikuar

2. "FASTECH" SH.P.K	3,131,400 lekë	skualifikuar
3. "FREDI ELECTRONIC" SH.P.K	3,343,000 lekë	kualifikuar
4. "KEJ Group" SH.P.K	3,478,224.80 lekë	kualifikuar
5. "PC STORE" SH.P.K	3,690,800 lekë	kualifikuar
6. "Skyline SC" SH.P.K	3,694,976 lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se me datë 29.04.2026 është publikuar Njoftimi i Fituesit Paraprak.

II.5. Në datën 29.04.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6596 dhe me nr. 1323/2026 prot., datë 29.04.2026 e operatorit ekonomik "Fastech" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt "Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM" me fond limit 4,080,942.50 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

II.6. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1323/1 prot., datë 29.04.2026.

II.7. Me datë 06.05.2026 përmes shkresës me nr. 1679/7 prot., datë 06.05.2026 me lëndë "Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Fastech" SHPK lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt "Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM" protokolluar me tonën me nr. 1323/2 prot., datë 06.05.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP informacion lidhur me ankesën e sipërcituar nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës duke u shprehur:

## II.

### Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

#### ARSYETON:

**II.1.** Në datën 29.04.2026, Operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania, pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokoll 1323/2026, datë 29.04.2026 dhe Nr aplikimi të ankesës online: A/2026/6596, nga ku rezulton se nuk është paraqitur mandatpagesa që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

Në Nenin 111 "Paraqitja e ankesës" të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

*"1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.*

*Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se*

mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

Gjithashtu në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu XII, Neni 94, përcaktohet se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm 84në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkeljes së pretenduar.

Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës për llogari buxhetit të shtetit. Dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën duhet t'i bashkëlidhet ankimit, që ankimuesi do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin.

Njoftimi bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.

5. Ankesa duhet të korrigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.

6. Formulari standard i ankesës hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.”

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, me anë të rubrikës “Kërkesë për informacion OE” nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, në datë 29.04.2026

dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësive të konstatuara lidhur me mosparaqitjen e dokumentit bankar, i cili vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 3 të Nenit 111 të LPP, u konstatua se plotësimi i kësaj mangësie nuk u korrigjua nga ana e Operatorit ekonomik ankimues.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

KSHA pas verifikimeve konstaton se Operatori ekonomik ankimues edhe pse i është vënë në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm ligjor në lidhje me mënyrën dhe formën paraqitjes së ankesës, ai sërish nuk ka mundur që të korigjojë mangësitë e identifikuara në lidhje me pagesën e tarifës financiare brenda 2 ditëve nga njoftimi.

Sa më sipër argumentuar, KSHA gjykon se për sa kohë, ankesa e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues "FASTECH" shpk nuk plotëson kushtet formale, siç është dhe pagesa e tarifës, rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

## **VENDOSI**

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "FASTECH" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.8. Përmes memos me nr.1323/3 prot., datë 07.05.2026, KPP ju drejtua Sektorit të Finances, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve të institucionit me qëllim verifikimin e statusit të pagesës së operatorit ekonomik "Fastech" SHPK me përmbajtje si vijon:

*"Në datën 29.04.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6596 dhe me nr. 1323/2026 prot., datë 29.04.2026 e operatorit ekonomik "Fastech" SHPK për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me Nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt "Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM" me fond limit 4,080,942.50 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*

*Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se statusi i pagesës për ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6596 dhe me nr. 1323/2026 prot., datë 29.04.2026 rezulton “pa paguar”.*

*Sa më sipër me qëllim vijim e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP, lutem përcjelljen e informacionit mbi statusin aktual të pagesës për ankesën e sipërpërmendur.”*

II.9. Informacionin për shqyrtimin e ankesës autoriteti kontraktor e dërgoi në KPP edhe përmes shërbimit postar i cili u protokollua me tonën me nr. 1323/4 prot., datë 08.05.2026.

II.10. Në përgjigje të kërkesës më sipër, Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve përmes shkresës me nr. 1323/5 prot., datë 12.05.2026 ka njoftuar KPP si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 1323/3 prot., datë 07.05.2026, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.1323/2026 prot., datë 29.04.2026 me numër ankimi elektronik A/2026/6596, Operatori ekonomik “Fastech” Shpk nuk ka paraqitur dokument bankar, që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimimit.

*Referuar raportit të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 07.05.2026, rezulton se Operatori Ekonomik “Fastech” Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”*

II.11. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ nuk rezulton të jenë paraqitur argumente në sistemin e ankesave elektronike nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të *lex specialis*.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fastech” SHPK në datën 29.04.2026 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor me numër ankimi elektronik A/2026/6596 dhe me nr. 1323/2026 prot., datë 29.04.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt “Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM” me fond limit 4,080,942.50 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara., KPP konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Me datë 06.05.2026 përmes shkresës me nr. 1679/7 prot., datë 06.05.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Fastech” SHPK lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt “Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM” protokolluar me tonën me nr. 1323/2 prot., datë 06.05.2026 autoriteti kontraktor ka ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike informacion lidhur me ankesën e sipërcituar nga ku rezultoi, se ka vendosur mospranimin e ankesës duke u shprehur:

## II.

### Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të paraqitur në SPE si dhe informacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit:

#### ARSYETON:

II.1. Në datën 29.04.2026, Operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet portalit e-Albania, pranë Komisionit të Prokurimit Publik me numër protokollit 1323/2026, datë 29.04.2026 dhe Nr aplikimi të ankesës online: A/2026/6596, nga ku rezultoi se nuk është paraqitur mandatpagesa që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur (Statusi i mandat pagesës: Pa paraqitur).

Në Nenin 111 “Paraqitja e ankesës” të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se

mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimuesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

Gjithashtu në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu XII, Neni 94, përcaktohet se:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm 84në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

2. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

3. Ankimuesi përdor formularin standard të ankesës, që përmban të paktën: emrin, adresën, adresën elektronike të ankimuesit, referencën e procedurës konkrete, bazën ligjore, si dhe një përshkrim të shkëlqes së pretenduar.

Ankimuesi është i detyruar të bëjë pagesën e tarifës për llogari buxhetit të shtetit. Dokumenti bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën duhet t'i bashkëlidhet ankimit, që ankimuesi do të paraqesë në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike. Kur është e mundur, ankimit i bashkëlidhet një kopje e aktit, që kundërshtohet.

4. Në rast se autoriteti/enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është bërë sipas formularit standard ose i mungon ndonjë prej elementeve të sipërpërmendura ose nuk është shoqëruar me mandat pagesën, duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin.

Njoftimi bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me veprimet e mësipërme, për korrigjimin e të metave të ankesës.

5. Ankesa duhet të korrigjohet dhe paraqitet në autoritetin/entit kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

Nëse ankesa nuk korrigjohet/plotësohet brenda këtij afati, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

Nëse afati i fundit bie gjatë ditëve të pushimit zyrtar, atëherë afati i fundit për plotësimin e ankesës do të jetë ditën pasardhëse të punës.

6. Formulari standard i ankesës hartohet nga APP-ja, në bashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik, dhe është pjesë e dokumenteve standarde të tenderit.”

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, me anë të rubrikës “Kërkesë për informacion OE” nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, në datë 29.04.2026

dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësive të konstatuara lidhur me mosparaqitjen e dokumentit bankar, i cili vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur.

Pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 3 të Nenit 111 të LPP, u konstatua se plotësimi i kësaj mangësie nuk u korrigjua nga ana e Operatorit ekonomik ankimues.

Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimues nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.

KSHA pas verifikimeve konstaton se Operatori ekonomik ankimues edhe pse i është vënë në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm ligjor në lidhje me mënyrën dhe formën paraqitjes së ankesës, ai sërish nuk ka mundur që të korigjojë mangësitë e identifikuara në lidhje me pagesën e tarifës financiare brenda 2 ditëve nga njoftimi.

Sa më sipër argumentuar, KSHA gjykon se për sa kohë, ankesa e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues “FASTECH” shpk nuk plotëson kushtet formale, siç është dhe pagesa e tarifës, rrjedhimisht kjo ankesë duhet refuzuar.

#### **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

#### **VENDOSI**

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “FASTECH” shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

III.1.3. Gjithashtu nga verifikimet rezulton se me datë 29.04.2026 në sistemin e ankesave elektronike, në seksionin “Komunikime”, “Komunikim i AK me OE” autoriteti kontraktor i ka dërguar operatorit ekonomik ankimues “Fastech” SHPK njoftimin për plotësimin e kushteve formale në lidhje me mandatin e pagesës me përmbajtje si vijon:

I nderuar Operator Ekonomik "FASTECH" me Nipt J81609010U,

Më datë 29.04.2026 është administruar ankesa e paraqitur nga ana juaj në sistemin elektronik të ankesave të Komisionit të Prokurimit Publik me Numër aplikimi të ankesës online: A/2026/6596 për procedurën e prokurimit "E hapur, e thjeshtuar", me objekt: "Blerje pajisje TIK per sektorin audio-video, Per QKMBM" nga ku rezulton se nuk është paraqitur dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

Për sa më sipër dhe referuar parashikimeve të pikës 3, të nenit 111 të LPP, të ndryshuar.

Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimuesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur,

lutemi për plotësimin e mangësisë së konstatuar mbi pagesën e mandatit lidhur me ankesën e sipërpërmendur. Në rast se korrigjimet e mësipërme nuk do të bëhen brenda dy ditëve, ankesa me Numër aplikimi të ankesës online: A/2026/6596 do të vlerësohet si e pa paraqitur.

Faleminderit për bashkëpunimin

III.1.4. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, sikurse është formulari përkatës dhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimuesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t'i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë *apriori*, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk çënon parimin e efijencës në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimuesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimuesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të ngarkuar në sistemin e ankesave elektronike më datës 06.05.2026 përmes shkresës me nr. 1679/7 prot., datë 06.05.2026 me lëndë "Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonbomik "Fastech" SHPK lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt "Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM" protokolluar me tonën me nr. 1323/2 prot., datë 06.05.2026, por edhe nga verifikimet e kryera në sistem rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes komunikimit në seksionin "Komunikime", "Komunikim i AK me OE" në sistemin e ankesave elektronike i ka kërkuar operatorit ekonomik "Fasech" SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, si në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave,

ankimimi, si dhe mundësia për të korigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis*, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi faktet dhe provat bashkëlidhur dokumentacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor thekson, se ky i fundit përmes komunikimit në seksionin “Komunikime”, “Komunikim i AK me OE” në sistemin e ankesave elektronike i ka kërkuar operatorit ekonomik “Fasech” SHPK, korigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës, nga ku konstatohet se operatori ekonomik ankimes “Fastech” SHPK nuk i është përgjigjur kërkesës së autoritetit kontraktor, duke mos rregulluar të metat e ankesës.

Gjithashtu përmes shkresës me nr. 1323/5 prot., datë 12.05.2026 Sektori i Financës, Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve ka njoftuar KPP si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 1323/3 prot., datë 07.05.2026, me lëndë: “Kërkesë për verifikim pagese”, ju bëjmë me dije se për ankesën me nr.1323/2026 prot., datë 29.04.2026 me numër ankimi elektronik A/2026/6596, Operatori ekonomik “Fastech” Shpk nuk ka paraqitur dokument bankar, që të vërtetojë kryerjen e pagesës për tarifën e ankimit.

Referuar raportit të dërguar nga Dega e Thesarit për arkëtimet e kryera deri më datë 07.05.2026, rezulton se Operatori Ekonomik “Fastech” Shpk nuk ka kryer pagesë në favor të Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën e sipërcituar.”

Sa më lart, konstatohet se ankimesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, për sa kohë, ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Fastech” SHPK pranë Komisionit Prokurimit Publik dhe autoritetit/entit kontraktor nuk plotëson një nga kushtet formale siç është pagesa e tarifës, kjo ankesë duhet refuzuar.

III.2. Gjithashtu KPP vëren se ankesa e operatorit ekonomik “Fastech” SHPK nuk ka plotësuar edhe kushtet formale për sa i përket legjitimit kohor në kuptim të pikës 2 të nenit 110 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.” Sa më sipër Komisioni vëren se,

III.2.1.Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën

*në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.”*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).”

III.2.2. Në nenin 97 pika 1 dhe 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor: a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës, ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.”

III.2.3. Në vlerësim të Vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 të Gjykatës Administrative të Apelit., **Pika III. Vlerësimi i Gjykatës, 31.** Për kushtin tjetër formal të padisë, respektimin e afatit ligjor.....: “... Praktika gjyqësore e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. (00-2017-927) 670, datë 30.05.2017, konfirmon të njëjtin qëndrim: “... Gjykata Administrative e Shkallës së Parë të Tiranës e ka zbatuar gabim ligjin për përllogaritjen e afatit të prerë të ankimit administrativ. Në këtë pjesë të çështjes, Kolegji konfirmon plotësisht bazueshmërinë në ligj të qëndrimit të Gjykatës Administrative të Apelit, se... edhe afatet e parashikuara nga neni 63 i Ligji për prokurimin publik duhet të interpretohet sikur rregullojnë të gjithë ligjet procedurale, sikur neni 62 i Kodit të Procedurave Administrative apo neni 148, 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile. **Sipas gjykatës së apelit, afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit...**”, si dhe duke u mbështetur në nenin 97 pika 5 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar siç është procedura e

prokurimit objekt ankimi, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të fituesit ose njoftimit të anulimit dhe në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të aktit rregullator të sipërcituar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.

III.2.4. Në rastin konkret referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, si dhe informacionit të dërguar nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së prokurimit objekt ankimi është publikuar me datë 29.04.2026. KPP vëren, se me datë 29.04.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6596 dhe me nr. 1323/2026 prot., datë 29.04.2026 e operatorit ekonomik “Fastech” SHPK. Ndërkohë nga verifikimi i sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), rezulton se po në datë (29.04.2026) kur është paraqitur ankesa nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pavarësisht se ishte publikuar njoftimi i fituesit paraprak, afati i ankimit nuk kishte filluar të ecte për operatorët ekonomikë pjesëmarrës pasi në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në pikën 5 të nenit 97 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse. Gjithashtu edhe në vlerësim të vendimit të sipërcituar të Gjykatës Administrative të Apelit afati i ankimit administrativ, nis të llogaritet gjithmonë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se referuar nenit 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret referuar dokumentacionit të administruar rezulton, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor përmes sistemit të ankesave elektronike përpara afatit të parashikuar nga neni 97 pika 5 e VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin parashikohet se: “5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse.” por edhe nga vlerësimi që Gjykata Administrative e Apelit përmes vendimit Nr. 74, datë 25.06.2025 i ka bërë nisjes së llogaritjes së afatit të ankimit administrativ. Në rastin konkret, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk kishte filluar ende, për sa kohë sipas parashikimeve më sipër dita e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak ( data 29.04.2026 kur edhe është paraqitur në sistem ankesa) nuk përfshihet në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës. Në këtë kuptim KPP gjykon, se ankesa e depozituar me datë 29.04.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, konsiderohet e paraqitur përpara afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të

ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve është i një rëndësie thelbësore, e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Fastech” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-81375-04-08-2026, me objekt “Blerje pajisje TIK për sektorin audio-video, Për QKMBM” me fond limit 4,080,942.50 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
  2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

